

FLETË INFORMUESE PËR PROJEKTIN

Emri i projektit	Fuqizimi i Standardeve Gazetareske – Avancimet Digjitale dhe Ndikimi në Mjedisin Mediatik (FY24 – YT -AJM -001)
E mbështetur nga	IREX në kuadër të Projektit të USAID-it për Edukim Mediatik “Të Rinjtë Mendojnë”
Roli i SHGM-së	Bartës i projektit
Buxheti total i projektit:	197,593 dollarë amerikanë
Partnerë të projektit	Instituti Maqedonas për Media (IMM) dhe Këshilli për Etikë në Media të Maqedonisë (KEMM)
Periudha e realizimit	Faza 1: Korrik 2024 – Prill 2025 Faza 2: Maj 2025 – Janar 2026
Territori	Maqedonia e Veriut
Për projektin	Projekti “Fuqizimi i Standardeve të Gazetarisë – Avancimet Digjitale dhe Ndikimi në Mjedisin Mediatik”, i mbështetur nga IREX, në kuadër të projektit të USAID-it për Edukimin Mediatik “Të Rinjtë Mendojnë”, ka si qëllim të përmirësojë cilësinë, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e praktikave gazetareske dhe mediatike në Maqedoni. Duke marrë parasysh se teknologjitë e reja dhe trendet mediatike kanë transformuar ndjeshëm mënyrën se si prodhohen dhe shpërndahen informacionet, ekziston një nevojë urgjente për rishikimin dhe përditësimin e standardeve etike sipas të cilave (duhet të) veprojnë mediat, gazetarët dhe punonjësit e medias.
Konteksti	Gazetaria në Maqedoninë e Veriut përballlet me shumë sfida, veçanërisht në kontekstin e zhvillimit të shpejtë të mediave digjitale dhe ndikimit të tyre në diskursin publik. Ekziston shqetësim se standardet etike ekzistuese, të cilat janë zhvilluar më shumë se një dekadë më parë, tashmë nuk i përmbushin nevojat dhe sfidat aktuale të gazetarëve dhe organizatave mediatike. Kjo moskoordinim shpesh çon në probleme siç janë eproria, dezinformimi dhe ulja e besimit në media, duke e vështirësuar punën edhe të trupave vetërregulluese mediatike.
Qëllimi	Qëllimi përfundimtar i projektit është të sigurojë një mjedis mediatik më të fuqishëm dhe etikisht të përgjegjshëm, i cili do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.
Grupet e cakut	Gazetarët dhe mediat, institucionet arsimore, organet ligjore dhe rregullatore, publiku më i gjerë/qytetarët.
Rezultate të pritshme	Një kod të ri që do të mbështetet gjerësisht nga komuniteti mediatik, duke siguruar kështu aplikimin e tij efektiv dhe qëndrueshmërinë afatgjate. Forcimi i kredibilitetit dhe besimit të publikut më të gjerë në historinë mediatike.
Aktivitete bartëse	Në kuadër të projektit, i cili do të realizohet në dy faza, parashikohen disa aktivitete, përfshirë: formimin e një grupi pune me përfaqësues të palëve të

	interesuara, një rishikim të thellë të praktikave aktuale të etikës në gazetarinë vendase, punëtori dhe takime me gazetarë dhe përfaqësues të mediave, analizë krahasuese dhe hartimin e një kodi të ri etik, mbështetje teknike dhe ekspertizë për trupat vetërregulluese në SHGM dhe KEMM, një fushatë mediatike dhe promovim të një kodi të ri etik, trajnim dhe udhëzues për mbështetje, si dhe një konferencë përfundimtare për projektin.
Logo	 The logos displayed are for IREX (International Reporting Excellence), USAID (United States Agency for International Development), and the Department of State. The USAID logo includes the tagline 'FROM THE AMERICAN PEOPLE'.